



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ADGJA.nr.2/2025

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga S.K., nga fshati R..., komuna e R...t, ndaj gjyqtares të Gjykatës së Apelit të Kosovës, M.B.R., lidhur me vendosjen në lëndën Cap.nr.405/2023, të Gjykatës së Apelit në Kosovë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 04.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga S.K., nga fshati R..., komuna e R...t, ndaj gjyqtares të Gjykatës së Apelit të Kosovës, M.B.R., lidhur me vendosjen në lëndën.Cap.nr.405/2023, të Gjykatës së Apelit në Kosovë.

A r s y e t i m

Me datën 20.01.2025, nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Gjykata e Apelit e Kosovës, e ka pranuar ankesën e S.K., nga fshati R..., komuna e R...t (i cili të njëjtes i është referuar si Padi për vërtetimin e pavlefshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit CAP.nr.405/23, mirëpo meqenëse në përmbajtjen e saj i është referuar Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve të njëjtën e trajtoj si ankesë disiplinore). Në ankesë ka theksuar se i njëjti ka ushtruar kundërshtim me datë 23.08.2018, prapsim me datë 23.07.2019 dhe ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë me datë 14.11.2022, por gjyqtarja M.B.R. i ka anashkaluar faktet e pakundërshtueshme nga asnjë shkallë gjyqësore, për fajin se borxhi prej 756.23 euro i përket F.K..

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës, me datë 22.01.2025, nga gjyqtarja e Gjykatës së Apelit të Kosovës, në lëndën Cap.nr.405/2023, ka kërkuar deklaram lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi S.K..

Gjyqtarja M.B.R., ka dhënë deklaratë me datën 24.01.2025, ku ka theksuar se me aktvendimin Cap.nr.405/23 të datës 22.11.2024, ka vendosur si në dispozitiv pas vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 78 të LPP, në të cilin nen janë paraparë garancitë për ankesa kundër vendimit lidhur me prapësimin për një kredi në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi ankesa nuk mund të shqyrtohet sipas paragrafit 4, të këtij neni ku parashihet se: “nëse pala ankuese dështon të paguajë shumën e garancisë të caktuar nga Gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese. Tutje ka theksuar se me paragrafin 5 të nenit 78 të LPP, është paraparë se “ankesa në gjykatën e shkallës së dytë mund të shqyrtohet pasi që të paguhet shuma e garancisë në gjykatën e shkallës së parë”.

Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarës M.B.R., ka gjetur se:

- ankesa e ankuesit S.K., është **e pabazuar.**

Kryetari i Gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi si dhe deklaratës së gjyqtarës, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket mënyrës së vendosjes, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se gjyqtarët janë të pavarur në vendimmarrje, pavarësi kjo e cila i’u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu gjyqtarët janë të pavarur në punë e tyre, vendosin sipas ligjit dhe vendimet merren në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim kryesor. Sipas vlerësimit të kryetarit, pavarësia individuale, është pavarësia e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor, që nënkupton se gjyqtarët duhet të jenë meritore, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor.

Lidhur me pavarësinë në vendimmarrje nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të pavend apo të pajustificuar në procesin gjyqësor dhe nuk duhet që vendimet gjyqësore të gjykatave t’i nënshtrihen ndryshimit. Në rastin konkret Kryetari i Gjykatës nuk ka kompetencë që të ndryshojë

vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjyqtari apo kolegji i gjyqtarëve dhe se pala e pakënaqur ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Apelit nëse vlerëson se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, i njëjti eventualisht mund të parashtrijë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ndërsa nëse vlerëson se ka baza të tjera ankimore, atëherë i njëjti eventualisht mund t'i drejtohet Gjykatës Supreme.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me vendosjen e çështjes së parashtruesit të ankesës, meqë me prova të shqyrtuara nuk është vërtetuar se gjyqtarja M.B.R. ka bërë shkelje të Kodit të Etikës.

Ndërkaq, për punën profesionale të gjyqtares apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

ADGJA.nr.2/2025, me datë 04.02.2025

Kryetari i Gjykatës

Valon Totaj

Vendimi t'i dorëzohet:

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtares M.B.R.
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,